



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes 71041-01889-11-2018 **Data e Regjistrimit** 7/30/2018
Numri i Vendimit 11-2018-5372 **Data e Vendimit** 11/23/2018

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Eda Kaja

ANËTAR

SEKRETARE Mimoza Cani

Objekti: Kundershtimi i Vendimit Nr.48/1 Vendimi date 15.02.2018 per Vendosjen e Sekuestros Preventive mbi pasurite e personit nen hetim ***** *****

Baza Ligjore : Neni 274, 276 dhe ne vazhdim i K.Pr.Penale.

Përmbledhja e vendimit:

Kërkuesi:

- Kundershtimin e vendimit Nr 48/1 date 15.02.2018 te per vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurite e personit nenhetim ***** *****

***** :

- Në lidhje me kerkesën ne vlerësim te gjykates.

Perfaqsesi i peronit te tretë:

- Rrëzimin e kerkeses.

Vëren:

Shtetasi Ildir Hoxha administrator i subjektit A.M.A.shpk me numër nipti K31424510A ne fushën e këmbimit valutur, ka kallëzuar shtetasen ***** , lidhur me shpërdorimin e besimit në kthimin e detyrimeve financiare të krijuara nga aktiviteti i kryer midis tyre nga muaji Nëntor 2016 e vijim i cili ka arritur në një shumë 935.432 (nëntëqindë e tridhjetë e pesëmijë katërqind e tridhjet e dy) Euro.

Shtetasia ***** me banim në Tiranë dhe administratore e subjektit tregtar "Shnedident" shpk, me numër nipti L71320014H në fushën e stomatologjisë i është prezantuar shtetasit Ildir Hoxha si mjekë e cila kishte në pronësi disa klinika dentare dhe konkretisht tetë klinika nga të cilat grumbullonte të ardhura të shumta në Lek dhe i duhej valut në Euro me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

qëllim blerjen e materialeve të shtrenjta për këtë fushë. Gjatë krijimit të marrdhënies së bashkëpunimit shtetasia ***** është prezantuar Ildirit si një biznesmene shumë e suksesshme si një person që ka lidhje të forta politike dhe njohje të mëdha në fushën e biznesit, si një person që nga të ardhurat e saj sponsorizon aktivitete bamirësie për shtresat në nevoje dhe si një person që ka nevojë për partner të sigurtë pasi aktiviteti i saj është shumë i suksesshëm dhe i qëndrueshëm. Për këtë qëllim ajo ka aktivizuar një rrjet të tërë informimi me anë të medias dhe rrjeteve sociale, me anë të reklamave të automjetit, si dhe me anë të reklamave të mëdha të vendosura nëpër rrugët e vendit nëpër Tiranë apo si ajo mbi urën Bistrotek në Sukth Durrës e cila është vendosur pikërisht në periudhën e lidhjes së marrdhënies midis palëve nga data 01.10.2016 deri në fund të muajit prill 2017.

Aktiviteti i kryer midis shtetasit Ildir Hoxha dhe ***** konsiston në këmbimin e parave midis tyre dhe gjatë një periudhe relativisht të shkurtër janë krijuar diferenca të qëllimshme nga ana e shtetasës ***** Dukës e cila ka kërkuar të këmbej para të llojit Lekë me para të llojit Euro nëpërmjet shtetasit Ildir Hoxha i cili është administrator i subjektit tregtar në fushën e këmbimit e emërtuar A.M.A.Shpk me qendër në Durrës.

Gjatë aktivitetit të kryer midis tyre ***** ka krijuar një diferencë të madhe në para ku fillimisht në ditët e para të aktivitetit ka sjellë para në Lekë dhe ka marrë kundër vleftën në Euro në mënyrë të përpiktë dhe më pas nisur nga besimi i krijuar nga ana e Ildir Hoxhës ajo ka sjellë para më pak sesa Eurot që kërkonte e që merrte duke krijuar kështu për një periudhë rreth dy mujore një diferencë shumë të lartë. Gjithashtu përgjatë një periudhe rreth një vjeçare ajo ka gënjer në mënyrë të përsëritur duke shpërdoruar besimin e tij për kthimin e këtyre shumave dhe duke përdorur nëçdo rast gënjeshtren se detyrimi do ulet, se ajo është duke punuar, se klinikat po punojnë shumë fortë, se paratë janë të sigurt, etj.

Ne kuader të këtij hetimi me vendimin nr 48/1 date 15.02.2018 është vendosur:

- Pranimin e kërkeses.
 - Vendosjen e sekuestros preventive, që parashikohet nga neni 274 i K. Pr. Penale, për apartamentet:
- 1- lloji i pasurisë apartament e gjendur në Tiranë zonen kadastrale nr.8380.nr. pasurisë 2/216+1-5 ,volumi I,faqe 32,Sh.I.K.3.Ap.5,
 - 2- lloji i pasurisë apartament e gjendur në Tiranë, zonen kadastrale nr.8310. nr.pasurisë 8/117+2-21,volumi nr.4 faqe 54, Sh.2. K.4. Ap.21,nr.references 803.
 - 3- lloji i pasurisë apartament e gjendur në L.nr.13 Plazh Durrës, zonen



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

kadastrale nr.8318.nr.pasurise 39/146+1-15 ,volumi 73 faqe 64,
Sh.I.Ap.I5.

- 4- Iloji i pasurise apartament e gjendur ne Tirane, zonen kadastrale
nr.8310. nr.pasurise 5/72+2-13, volumi 4 faqe 152 referenca 5292.

Nga ana e kerkuesit ***** përmbartimore "Besa" shpk me datë
30.07.2018, është paraqitur në Gjykate kërkesa me objekt: Kundërshtimin e
vendimit Nr 48/1 date 15.02.2018 te per vendosjen e sekuestros preventive
mbi pasurite e personit nenhetim *****

Gjykata shqyrtoi me kujdes të gjithë materialet e ceshtjes ku rezulton se per
pasurine e sekuestruar te sipercituar, eshte leshuar nje urdher ekzekutimi
vendimi nr 2310 date 12.03.2018 nga gjykata e rrethit gjyqesor Tirane dhe se
nga ana e kerkuesit shoqerise "Besa" shpk si pale e interesuar kerkohet
heqja e sekuestros pasi e kane te pamundur per te vazhduar me procedurat
per fazat e tjera te ekzekutimit.

Gjykata vleron se, vendimi i dates 15.02.2018 qe ka vendosur sekuestron
preventive per pasurite e paluajtshme, eshte bere ne perputhje me nenin 274
te K.Pr.Penal ne te cilin citohet se:

*" ...Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale
mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të 153 lehtësojë kryerjen e
veprave penale të tjera, ...*

*Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale
dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit
Penal.... "*

Gjithashtu gjykata, vleron se qe nga moment i venies se sekuestros nuk
rezulton te kete ndryshim te kushteve te zbatimit te kesaj mase, per te
urdheruar heqjen e sekuestros se vene me vendimin Nr 48/1 date
16.02.2018 te Gjykates se rrethit gjyqesor Durres.

Per shkaqet e mesiperme, Gjykata vlereson se kërkesa e bërë nga kërkuesi
kerkuesit ***** përmbartimore "Besa" shpk nuk është e mbështetur në
prova dhe ligj e duhet rrëzuar.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Ne zbatim të nenit nenet 274 e vijues te Kodit te Procedures Penale, Gjykata



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit shoqërisë përmbartimore "Besa" shpk, me objekt: Kundershtimi i Vendimit Nr.48/1 Vendimi date 15.02.2018 për Vendosjen e Sekuestros Preventive mbi pasuritë e personit nën hetim *****: si të pa bazuar në prova dhe në ligj.
2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuarit
3. Kunder vendimit mund të bëhet ankimi në Gjykatën e Apelit Durres brenda 10 ditëve) ditëve nga e nesërmeja e shpalljes së tij.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.